



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 45 prot.

Kamëz, më 17.06.2022

V E N D I M
Nr. 62 .Datë 17/06 2022
M B I

“MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.06.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.59 Datë 13.06.2022 në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362 date 20.05.2019 “Per kriteret e dhenies subvencionimit qirase per kategorite qe gezpjne perparesi ne subvencionimin e qirase ne tregun e lire, nepermjet buxhetit te shtetit dhe menyren e llogaritjes se tij”; VKM nr. 459 date 03.09.2019 “Rregullat per administrimin e kerkesave te njesive qeverisjes vendore per fonde nga buxheti i shtetit per subvencionimin e qirase ose uzufruktit, menyren e financimit te subvencionimit, monitorimin dhe bashkepunimin ndermjet NJQV dhe ministrise pergjegjese per strehim”; Udhezim nr.31 dt.18.11.2019 “Per procedurat standarte te aplikimit dhe kriteret per perfitimin e fondeve nga buxheti shtetit per programet e strehimit”; Vendimit nr.65 datë 25.06.2020, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”; Vendimit nr.4 datë 17.01.2022 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë në Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”; VKB nr. 132 datë 22.12.2021 “Për miratimin e detajmit të buxhetit të vitit 2022; Vendimit nr.152 datë 18.12.2020 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë për Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”, Vendimit nr 160 dt.23.12.2020 për “ Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2021,2022,2023”, shkresës me nr.prot.1237 dt.24.01.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Relacionit Komisionit strehimit me nr.5174 Prot datë 09.06.2022; Proçes-verbalit Komisionit Strehimit me nr. Prot 5174/1 datë 09.06.2022, **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

V E N D O S I :

1. Miratimin e trajtimit me subvencionin e qirasë për individët/ familjet, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë nga muaji Qershor 2022 deri në Dhjetor 2022.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika 1 në shumën prej 1,982,400 (një milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e dymijë e katërqind) lekë në muaj, do të përballohen me bashkëfinancim në raportin (80%-20%) në masën prej 1,585,920 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e njëzetë) lekë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe me vlerë 396,480 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë nga buxheti i Bashkisë Kamëz.
4. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.

Bashkëngjitur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

**Kryetar Këshilli
Hysen KOLDASHI**